



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV ZOOM
Ranko Makic
Drejtor
Kufcë e Epërme

Ankesa Nr. 2014/121 KPM vs TV ZOOM
Ref: 1409/1038/KPM/nr

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2014/121 -Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër TV ZOOM ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Pala Përgjegjëse, me datën 12 mars 2010, është pajisur me licencë të KPM-së. Me marrjen e Licencës Pala Përgjegjëse është obliguar të respektoj Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, përfshi këtu edhe pjesën e dytë të Licencës me të cilën përcaktohen parametrat dhe kushtet teknike të licencës si dhe vendndodhja e transmetuesit.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 31 gusht 2011, ka pranuar një kërkesë nga Pala Përgjegjëse lidhur me ndryshimin e vendndodhjes së transmetuesit nga pika Gornje Kufce për të cilën pikë është licencuar, në pikën Maja Gjelbër.
3. KPM e ka njoftuar Palën Përgjegjëse se në mungesë të organit vendimmarrës ka qenë e pamundur të shqyrtohet kjo kërkesë dhe ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që të mos ndërmer asnjë veprim për ndryshim të vendndodhjes së transmetuesit pa miratim paraprak të KPM-së.
4. Me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, KPM me datë 13 gusht 2012, ka bërë një monitorim teknik në terren dhe ka konstatuar se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka ndryshuar vendndodhjen e transmetuesit dhe e ka vendosur atë në pikën Maja e Gjelbër pa miratim paraprak të KPM-së.
5. KPM duke u bazuar në raportin e Departamentit të Menaxhimit Frekuencor, me datë 15 gusht 2012, përmes një letre ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që në afat prej 14 ditësh ta

kthej transmetuesin në pikën e transmetimit në Gornje Kufce, për të cilën është licencuar nga KPM, me qëllim që të veprojë në pajtim me parametrat teknik të përcaktuar me pjesën 2 dhe 4 të Licencës.

6. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Përgjegjëse me nenin 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, me datën 13 shtator 2012, ka bërë edhe një monitorim tjetër dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër letrës të datës 15 gusht 2012, ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, duke mos e kthyer transmetuesin në pikën e transmetimit për të cilën është licencuar nga KPM-ja.
7. KPM sërish me datë 12 dhjetor 2012, ka realizuar edhe një monitorim teknik në terren për të verifikuar vendndodhjen e transmetuesit të Palës Përgjegjëse dhe ka gjetur se ky subjekt vazhdon të transmetoj në pikën për të cilën nuk është licencuar nga KPM-ja.
8. KPM me datë 13 dhjetor 2012, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Urdhër përmes të cilit ka kërkuar që menjëherë të kthehet në pikën e transmetimit për të cilën është licencuar nga KPM-ja, në të kundërtën KPM do të ndërmer masa sanksionuese ndaj Palës Përgjegjëse në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së.
9. KPM sërish me datën 24 dhjetor 2012, ka realizuar edhe një tjetër monitorim teknik në terren për të konstatuar nëse Pala Përgjegjëse ka vepruar në pajtueshmëri me Urdhrin e KPM-së. Bazuar në raportin e Departamenti të Menaxhimit Frekuencor është gjetur se edhe përkundër Urdhrit Pala Përgjegjëse nuk është kthyer në pikën e transmetimit për të cilën është licencuar nga KPM-ja.
10. KPM në vazhdimësi ka bërë monitorime teknike të Palës Përgjegjëse dhe ka konstatuar se, edhe përkundër shkresave të shumta dhe përpjekjeve të vazhdueshme të KPM-së që Pala Përgjegjëse të vie në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës. Në bazë të raportit të fundit të monitorimit teknik të datës 24 qershor 2014, i bërë nga Departamenti i Menaxhimit Frekuencorë, është gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, pasi që transmeton nga pika Maja e Gjellbërt pa miratim paraprak nga ana e Komisionit të KPM-së.

Analiza Ligjore

11. Komisioni, bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse në mënyrë të vazhdueshme ka vepruar në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, respektivisht me nenin 6, paragrafi 1.

Neni 6, paragrafi 1, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton se:

“Përveç dispozitave për transferimin e pronësisë të specifikuar në Nenin 5.0, i Licencuari mund të bëjë kërkesë për ndryshimet e specifikuara në paragrafët e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Përhapjes Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit, duke ia bërë me shkrim kërkesën për këto ndryshime

KPM-së. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm me miratim paraprak me shkrim nga ana e KPM-së”.


12. Komisioni duke u bazuar në raportet e monitorimeve teknike të realizuara nga Departamenti i Menaxhimit Frekuencor të Zyrës Ekzekutive të KPM-së gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marr hapat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
13. Komisioni, bazuar në raportet e monitorimeve teknike, ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Urdhrit ka vazhduar të veproj në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka dështuar të kthehet në pikën e transmetimit për të cilën është licencuar nga KPM-ja.
14. Komisioni, bazuar në monitorimet e vazhdueshme të Palës Përgjegjëse, ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas Urdhrit të dërguar nuk ka ndërmarr asnjë veprim në drejtim të respektimit të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, duke vazhduar të transmetoj nga lokacioni për të cilin nuk është licencuar nga KPM.
15. Komisioni duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse në mënyrë të vazhdueshme ka vepruar në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, prandaj Komisioni, si rrethanë rënduese për Palën Përgjegjëse merr shkeljet e vazhdueshëm edhe përkundër kërkesave të KPM-së për të vepruar në pajtueshmëri me Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Vendim

16. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
17. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, pasi që ka bërë ndryshim të vendndodhjes së transmetuesit pa miratim paraprak nga KPM-ja.
18. Komisioni, duke u bazuar në shkeljet e vazhdueshme të nenit 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, obligon Palën Përgjegjëse që menjëherë ta kthej transmetuesin në pikën Gornje Kufce për të cilin është licencuar nga KPM.
19. Komisioni, bazuar në shkeljen e vazhdueshme të nenit 6, paragrafi 1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, vendos që Palës Përgjegjëse t'i shqiptojë masën sanksionuese me pezullim të të gjithë programit për periudhën tre (3) muajore, konform nenit 30 pika 1.4 të Ligjit të KPM-së.
20. Pala Përgjegjëse obligohet që brenda afatit 10 ditore nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të kthej transmetuesin në pikën për të cilën është licencuar nga KPM-ja dhe të filloj pezullimin e të të gjithë programit për periudhën tre (3) muajore. Dështimi i Palës Përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi do të rezultojë me ndërprerjen e licencës së transmetimit, konform nenit 30, paragrafi 1.6, të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

21. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.
22. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.


Adnan MEROVCI
Kryetar i Komisionit
Komisioni i Pavarur i Mediave



16.09.2014
Datë